



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:050434

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05847929

KPPP.nr.1262/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Viva Sandro Bruschi” Via Nouva di Castellare, 22-51100 Bottegone (Pistoia) Itali, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Muhamet Humolli avokat nga Prishtina Rr.”Andrio Gropa” pn, kundër debitorit N.T.P. “Agrocop” me NRB:80105576, me seli në Shtime, Rr.”K.Kumanova” nr.302, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” me seli në Prishtinë, Soliteri Avalla P+12, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.133/19 të datës 04.11.2019, të Përmbartuesit Privat Isak Islami, me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET prapësimi i debitorit N.T.P. “Agrocop” me NRB:80105576, ashtu që ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.133/19 të datës 04.11.2019, i Përmbartuesit Privat Isak Islami.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Viva Sandro Bruschi” Via Nouva di Castellare, 22-51100 Bottegone (Pistoia) Itali, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.133/19 të datës 04.11.2019, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht fatura me numër 2461 e datës 20.11.2013, fatura me numër 1872 e datës 19.07.2013, fatura me numër 2429 e datës 15.11.2013, fatura me numër 2470 e datës 21.11.2013, fatura me numër 1134 e datës 07.04.2014, fatura me numër 1798 e datës 30.06.2014, fatura me numër 2046 e datës 18.09.2014, fatura me numër 2040 e datës 18.09.2014, fatura me numër 2054 e datës 19.09.2014, fatura me numër 2073 e datës 23.09.2014, fatura me numër 1429 e datës

07.05.2015, fatura me numër 2027 e datës 02.10.2015, fatura me numër 931 e datës 07.04.2016, fatura me numër 2308 e datës 19.11.2015, fatura me numër 1118 e datës 24.04.2016, fatura me numër 1624 e datës 13.09.2016 dhe fatura me numër 1651 e datës 21.09.2016, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t'ia paguaj kreditorit në emër të borxhit sipas faturave të lartcekura në shumë prej 39,946.00, në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbare, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Prapësim kundër urdhrin përmbare brenda afatit ligjor ka paraqitur debitori, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për përmbare si të pa bazuar, ndër të tjerash ka theksuar se faturat mbi të cilat është iniciuar propozimi për përmbare janë të vitit 2013, 2014, 2015 dhe 2016, ndërsa propozimi për përmbare është dorëzuar me datë 04.11.2019, andaj konsideron se faturat respektivisht i gjithë borxhi i kërkuar është parashkruar në përputhje me nenin 355 të LMD-së, pasi që propozimi është paraqitur pasi kanë kaluar tri vite për secilën faturë veç e veç. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet në tërësi dhe urdhri përmbare P.nr.133/19 i datës 04.11.2019, të anulohet në tërësi si i pa bazuar.

Kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, me arsyetimin se nuk ka bazë ligjore për prapësim dhe se ekziston obligimi ndaj kreditorit në bazë të dokumentit të besueshëm. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet urdhri për përmbare dhe të refuzohet prapësimi i debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbare duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbare ka lejuar përmbaremin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbare e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaremin vetëm në bazë të dokumentit përmbare (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, gjeti se faturat, në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përmbardim dhe është lejuar urdhri përmbardimor janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 36 të LPP-së.

Nga të lartcekurat rezulton se propozimi për përmbardim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopje e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbardimore, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1 të LPP-së: *“Propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*.

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbardueshmërisë së nxjerrë nga përmbarduesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbardimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarduesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbardim nga përmbarduesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*

Andaj, Gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbardimit P.nr.133/19 i datës 04.11.2019, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbardim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumenteve përmbardimore dhe rrjedhimisht propozimi për përmbardim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga Gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, Gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të Gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbardim, ndërsa organi përmbardues - përmbarduesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbardim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbardues do të*

veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”, Gjykata shfuqizoi urdhrin përmbarimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.1262/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.